



**UTICA
COMMUNITY
SCHOOLS**

Robert S. Monroe
Superintendent of Schools
11303 Greendale
Sterling Heights, MI 48312
(586) 797-1100
www.UticaK12.org

I dashur nxënës i UCS,

Jemi të përgatitur dhe entuziastë t'ju shoqërojmë në hapat tuaj finalë në Utica Community Schools!

Ashtu siç kemi punuar me ju nga momenti i parë që filluat shkollën në qarkun tonë, familja jonë e UCS është e gatshme të vazhdojë të punojë për t'ju përgatitur për një cikël 'Junior High' të suksesshëm. Këshilltarët e 'Junior High' dhe 'High School' do të punojnë së bashku për të implementuar planin arsimor të zhvilluar posaçërisht për ju, bazuar në interesat, stilin e të mësuarit dhe qëllimet tuaja. Ju inkurajojmë të rishikoni këtë plan duke hyrë në llogarinë tuaj Xello në Uticak12.org/ClassLink.

Ne do të komunikojmë me ju dhe prindërit/kujdestarët tuaj rregullisht, nëpërmjet mesazheve tona qarkore, ndërkohë që ju kaloni këtë periudhë të rëndësishme tranzicioni. Hapi tjetër i rëndësishëm do të hidhet këtë pranverë, në kohën kur këshilltarët e High School vizitojnë shkollat tona Junior High për zgjedhjen e kurseve. Komunikime të mëtejshme rreth këtij procesi do të shpërndahen në momentin që bëhen të disponueshme.

Ndërsa përparojmë së bashku në këto vite të shkollës së mesme, ju lutemi të konsultoni seksionin "Academics" në faqen tonë të internetit UticaK12.org, për udhëzime dhe për informacion të zgjeruar rreth kërkesave për diplomim, gatishmërinë për kolegji dhe karrierë, shërbimet tona këshillimore, udhëzimet e programeve studentore dhe më tej.

Gjithashtu, për të mësuar më shumë rreth programeve dhe shërbimeve që janë në dispozicion të nxënësve, të UCS ju inkurajojmë të merrni pjesë në eventin "Pathways to Success" në 9 Dhjetor 2025 (për informacion të mëtejshëm ju lutemi konsultoni broshurën e bashkëngjitur). Si qarku i dytë më i madh shkollor i Michigan-it, Utica Community Schools u ofron nxënësve opsione cilësore të krijuara për të mbështetur prirjet, talentet dhe stilin tuaj të të mësuarit. Anëtarë të stafit të çdo shkolle të mesme do të jenë prezent në event për t'ju përgjigjur çdo pyetjeje që ju ose familja juaj mund të keni në lidhje me shkollën.

I gjithë ekipi ynë i UCS është krenar të punojë me një nxënës si ju që është rritur mes nesh. Ne jemi të gatshëm t'ju mbështesim në këtë udhëtim të ri drejt ciklit të mesëm shkollor, ndërsa përgatiteni të transformoni pozitivisht të ardhmen tuaj dhe botën.

Sinqerisht,

Robert S. Monroe

Drejtori i Përgjithshëm i Qarkut

Utica Community Schools Board of Education

Mary K. Smolenski, Ph.D. - President • Denyeal Nesovski - Vice President • Michael Austerman- Trustee
Kelli Rankin - Secretary • Kimberly Becker - Trustee • Steven R. Meyer Ph.D. - Treasurer • Machele Fitzpatrick - Trustee